

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

DREJTIMI: NDËRKOMBËTAR



PUNIM DIPLOME MASTER

**TEMA: RISTRUKTURIMI DHE REFORMIMI I OKB-SË, ANËTARËSIMI MË I GJERË NË
KËSHILL TË SIGURIMIT, E DREJTA E VETOS DHE EKUILIBRI I FORCAVE SIPAS
KARTËS SË OKB-SË**

Mentor:

Prof. Dr.Enver Hasani

Kandidatja:

Mirlinda Fana

Prishtinë, 2024

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij hulumtimi është trajtimi gjithëpërfshirës i Këshilli të Sigurimit, si organi kryesor i Kombeve të Bashkuara, duke filluar me trajtimin dhe përshkrimin e rrethanave dhe kontekstit historik në të cilin është themeluar ai, për të vazhduar me konstatimin e rrethanave të ndryshuara dhe aftësisë së KS-së për t'ju përgjigjur situatave të krijuara kundrejt përgjegjësisë së tij sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara, në funksion të identifikimit të nevojave për reformim, shkallën e këtyre reformave që duhen bërë dhe mënyrën e realizimit të tyre, si dhe analizimin e propozimeve të paraqitura në kuadër të debatit historik dhe aktual në OKB për reformën e Këshillit të Sigurimit.

Pyetjet kryesore, të cilave që do të përpiqemi të ju përgjigjemi, janë:

- Përgjatë gjithë ekzistencës së tij, a ka arritur Këshilli i Sigurimit t'i përmbushë përgjegjësitë sipas Kartës së OKB-së dhe cili ka qenë burimi i dështimit në realizimin e këtij misioni?
- Pse nuk ka progres të dukshëm në procesin e reformës (ndryshimit, transformimit, etj.) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së?
- A i plotësojnë propozimet aktuale, kërkesat e përgjithshme, konsideratat kryesore dhe argumentet të cilat janë paraqitur gjatë gjithë debatit për reformimin e Këshillit të Sigurimit?

Ky punim nuk është menduar të jetë një studim për të funksionuar si propozim për reformë; por synon t'i paraqesë dhe analizojë diskutimet mbi reformën e Këshillit të Sigurimit në përgjithësi, duke marrë parasysh dhe paraqitur këndvështrime të ndryshme në mënyrë që të shihet e gjithë tabloja, që do të thotë divergjenca në perspektivë e të gjitha shteteve anëtare.